

**ANALIZË MBI LIGJIN PËR
DETYRAT, PËRGJEGJËSITË
DHE KOMPETENCAT E
DELEGACIONIT SHETËROR
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

**NË PROCESIN E
DIALOGUT ME
REPUBLIKËN E
SERBISË**

MARS, 2019

Përgatiten: **Jeta Krasniqi, Florent Spahija, Violeta Haxholli, Eugen Cakolli**

COPYRIGHT © 2019. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohet në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi,
Nr. 45, 10 000, Prishtinë, Kosovë.
Tel.: +381 (0)38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Ueb: www.kdi-kosova.org

Vërejtje: Ky raport është rezultat i një hulumtimi që është realizuar në kuadër të projektit "Perspektiva Evropiane – ndërtimi i konsensusit kombëtar për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë", i financuar nga Ambasada Zvicerane në Prishtinë.

Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e Institutit Demokratik të Kosovës, dhe në asnjë rrethanë nuk do të konsiderohet që reflekton qëndrimet e Ambasadës Zvicerane në Prishtinë.

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka bërë një analizë të ligjit për detyrat, përgjegjësit dhe kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikës e Serbisë ku ka identifikuar një sërë çështjesh dhe ka ngritur disa pyetje lidhur me përmbajtjen e këtij ligji.

KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të Nenit 65 (1) të Kushtetutës
së Republikës së Kosovës,
Miraton:

LIGJ PËR DETYRAT, PËRGJEGJËSITË DHE KOMPETENCAT DELEGACIONIT SHTETËROR REPUBLIKËS SË KOSOVËS PROCESIN E DIALOGUT REPUBLIKËN E SERBISË

KREU I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Fushëveprimi i ligjit

1. Ky ligj përcakton hierarkinë institucionale dhe procedurën vendimmarrëse në Procesin e Dialogut me Republikën e Serbisë (tutje: Dialogu). Po ashtu, rregullon funksionimin e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës për Dialogun me Serbinë (tutje: Delegacioni Shtetëror), duke përcaktuar strukturën organizative, veprimtarinë, kompetencat dhe përgjegjësitë e Delegacionit Shtetëror. Mes tjerash, ligji definojnë qartë edhe ndërlidhjen që Delegacioni Shtetëror mbanë me institucionet tjera kushtetuese të Republikës së Kosovës.

KOMENTET NGA INSTITUTI DEMOKRATIK I KOSOVËS (KDI):

KREU I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Fushëveprimi i ligjit

Përmes nenit 1 paragrafi 1 ky ligj synon të rregullojë hierarkinë institucionale të Republikës së Kosovës në çështjen e dialogut me Serbinë dhe procedurën vendimmarrëse për këtë proces.

Hierarkia institucionale dhe vendimmarrëse përcaktohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Sipas rregullave të përgjithshme me anë të ligjeve nuk mund të ndryshohen prerogativat e parapara me Kushtetutë.

Me Nenin 4 të Kushtetutës së Kosovës, Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë.

KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

2. Ky ligj e ka statusin e Lex Specialis. Në rast të kolizionit të ndonjë dispozitë tjetër ligjore me këtë ligj do të mbizotërojnë nenet e këtij ligji.

Neni 2

Synimi dhe qëllimi

Në pajtim me këtë ligj, Delegacioni Shtetëtor i Republikës së Kosovës për Dialogun me Republikën e Serbisë autorizohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës për negociim dhe arritje të marrëveshjeve gjatë procesit të Dialogut, në konsultim me Institucionet Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

KOMENTET NGA INSTITUTI DEMOKRATIK I KOSOVËS (KDI):

Sipas nenit 1 paragrafi 2 ky ligj ka status Lex Specialis. Si pasojë, Kuvendi i heq të drejtat dhe detyrimet institucioneve kushtetuese që parashihen me ligjin për marrëveshjet ndërkombëtare. Përkatësisht, autorizimet dhe procedurat që institucionet shtetërore duhet ti ndjekin në çështjet që ndërlidhen me marrëveshjet ndërkombëtare sipas [Nenit 6 dhe Nenit 7](#).

Përkundër faktit që është ligj me status Lex Specialis, ky ligj nuk mund ti ndryshoj kompetencat kushtetuese dhe vendimarrëse të Kuvendit të Kosovës për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare.

Neni 2

Synimi dhe qëllimi

Nga leximi i nenit 2, nuk është e qartë se si do të realizohet konsultimi me institucionet kushtetuese të Republikës së Kosovës në lidhje me procesin e dialogut me Republikën e Serbisë.

Ligji duhet të përcaktojë procedurat e konsultimit në mes të delegacionit shtetëror dhe institucioneve kushtetuese të Republikës së Kosovës. Gjithashtu ligji duhet të përcaktoj se me cilat institucione kushtetuese duhet të bëhet konsultimi.

Neni 3

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:

1.1. **Dialogu** - Faza përmblylëse e Dialogut me Serbinë e cila fillon me mandatin e Delegacionit Shtetëror me qëllim të arritjes së një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse mes Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë. Kjo marrëveshje gjithëpërfshirëse do të nënkuptojë njohje formale dhe reciproke mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë.

1.2. **Ditë** - ditët kalendarike.

1.3. **Delegacion Shtetëror** - Delegacioni Shtetëror i Republikës së Kosovës për Dialogun i cili mandatohet nga Kuvendi.

1.4. **Shoqëria civile** - një anëtar nga shoqëria civile, pjesë e Delegacionit Shtetëror me të drejtë vote.

1.5. **Komisionet punuese** - grupe përfaqësuese profesionale të themeluara nga Delegacioni Shtetëror në përshtatshmëri me temat që trajtohen gjatë procesit negociator.

1.6. **Komision Ad Hoc Parlamentar për Mbikëqyrjen e Dialogut** - organ i ngritur me vendim të Kuvendit në pajtim me Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Neni 3

Përkufizimet

Neni 3 paragrafi 1.1. Dialogu - faza përmblylëse fillon me mandatin e delegacionit shtetëror

Mbetet e paqartë çështja se çfarë ndodh me procesin tashmë të filluar rreth fazës përmblylëse të dialogut Kosovë-Serbi të udhëhequr nga Presidenti i vendit z. Hashim Thaçi. Si do të trajtohet ky proces? Çfarë do të ndodh me temat e diskutimit të cilat tashmë kanë filluar të negociohen në Bruksel në kuadër të kësaj faze të dialogut?

Tutje, mungon përkufizimi se çfarë saktësisht nënkupton procesi i dialogut.

Neni 3 paragrafi 1.4. Shoqëria civile - duhet të përcaktohet se çfarë nënkupton ky ligj me shoqërinë civile, jo numrin e anëtarëve të përfaqësuar në delegacionin shtetëror.

A nënkuptohet me termin shoqëria civile ashtu siç parashihet e njëjta në ligjin për lirinë e asociimit?

KREU II

**DISPOZITAT THEMELORE
THEMELIMI I DELEGACIONIT
SHTETËROR, PËRBËRJA,
KOMISIONET PUNUESE,
KOMISIONIT MBIKËQYRËS
PARLAMENTAR**

Neni 4

**Procedura për ngritjen e Delegacionit
Shtetëror**

Delegacioni Shtetëror për dialogun me Republikën e Serbisë do të mandatohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Delegacioni Shtetëror do të jetë organi i vetëm i autorizuar për ta drejtuar Dialogun. Në këtë drejtim Delegacioni konsultohet me Institucionet kushtetuese të Republikës së Kosovës.

KREU II

**DISPOZITAT THEMELORE
THEMELIMI I DELEGACIONIT
SHTETËROR, PËRBËRJA,
KOMISIONET PUNUESE,
KOMISIONIT MBIKËQYRËS
PARLAMENTAR**

Neni 4

**Procedura për ngritjen e Delegacionit
Shtetëror**

Neni 4 i këtij ligj si Lex Specialis ia merr kompetencat që parashihen me ligje të tjera për Presidentin dhe Qeverinë. Ndryshe nga ligji për marrëveshje ndërkombëtare që parasheh që autorizimi duhet të vijë nga Presidenti për çështjet që kanë të bëjnë me paqen, territorin. Ky ligj autorizon Kuvendin të bëjë mandatin e delegacionit shtetëror.

Me këtë ligj Kuvendi autorizon delegacionin shtetëror si organin e vetëm për të drejtuar dialogun me Serbinë. Por ky nen dhe ky ligj nuk mund ti marr kompetencat kushtetuese të institucioneve (Presidenti, Qeveria, Kuvendi) në politikën e jashtme.

Neni 5

Përbërja e Delegacionit Shtetëror

1. Delegacioni Shtetëror përbëhet nga njëmbëdhjetë anëtarë (12). Delegacioni përbëhet nga përfaqësues të koalicionit qeverisës dhe të Opozitës, në proporcion sa më të përafërt të përfaqësimit. Diferenca e përgjithshme e anëtarëve në proporcionin Qeveri-Opozitë në kuadër të Delegacionit nuk mund të jetë më shumë se dy (2) anëtar i Delegacionit Shtetëror.

2. Nominimet për anëtarë të Delegacionit Shtetëror bëhen nga përfaqësues të partive parlamentare në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Në rast se një parti parlamentare nuk i përgjigjet kërkesës me kohë, Kuvendit i propozohen nominimet e bëra nga parti të tjera parlamentare. Në rast të tillë, pozitën e pa-nominuara plotësohen nga përfaqësues të këtyre partive duke ruajtur proporcionin e paraprakë të përfaqësimit Qeveri-Opozitë.

3. Delegacioni Shtetëror bashkëdrejtohet barabarësisht prej (dy) përfaqësuesve: njëri nga radhët e Opozitës parlamentare e tjetri nga Koalicioni Qeverisës. Që të dy bashkëdrejtuesit votohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, së bashku me anëtarët e tjerë të Delegacionit Shtetëror.

4. Pjesë e Delegacionit Shtetëror do të jetë edhe një përfaqësues nga Shoqëria Civile i cili/e cila do të jetë anëtar i rregullt i Delegacionit Shtetëror. Përfaqësuesi i shoqërisë civile do të emërohet nga Delegacioni Shtetëror.

Neni 5

Përbërja e delegacionit shtetëror

Neni 5 paragrafi 2. Duhet të definohet qartazi afati kohor për të cilin flet ky nen, kur adreson propozimet për nominimet nga partitë parlamentare për anëtarët e Delegacionit shtetëror.

Neni 5 paragrafi 3. Që të dy bashkëdrejtuesit votohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, së bashku me anëtarët e tjerë të delegacionit shtetëror.

A do të thotë kjo që edhe tre anëtarët e tjerë të cilët nuk janë votuar nga Kuvendi, emrat e tyre duhet të shkojnë në Kuvend për tu votuar? Apo Kuvendi duhet të votoj sërish të të tërë përbërjen e delegacionit për të marr mandatin e dhënë me këtë ligj? Ligji nuk sqaron mandatin e të votuarëve me Rezolutën 06 - R - 015 e miratuar nga Kuvendi. Çështjet e njëjta vlejné edhe për paragrafin 5 të këtij neni.

Neni 5 paragrafi 4. Përfaqësues i shoqërisë civile do të emërohet nga delegacioni shtetëror.

Mbi çfarë procedurash dhe kriteresh do të bëhet përzgjedhja e anëtarit të shoqërisë civile në këtë delegacion? A do të votohet në Kuvend siç votohen anëtarët e shoqërisë civile nëpër trupa kolegjal (p.sh. Këshilli Prokurorial i Kosovës)

KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

5. Delegacioni Shtetëror me përbërjen e tij votohet nga deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe konsiderohet i mandatuar kur i merr shumicën e thjeshtë të votave të deputetëve.

6. Kuvendi i Republikës së Kosovës rezervon të drejtën ta shkarkojë Delegacionin, ose anëtarët e caktuar të tij, me 50%+1, të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

7. Delegacioni Shtetëror mund të shkarkohet kur:

7.1. Nuk i përmbush detyrat dhe përgjegjësitë e caktuara me këtë ligj;

7.2. Nuk i përgjigjet Komisionit Mbikëqyrës të Dialogut në së paku 3 ftesa;

7.3. Evidentohen shkelje të procedurave të vendosura me këtë ligj;

7.4. Evidentohen shmangie nga Platforma Shtetërore gjatë procesit të Dialogut.

7.5. Kërkesën për shkarkim të Delegacionit shtetëror, ose të anëtarëve të veçantë të tij, mund ta paraqesin Bashkëdrejtuesit e Delegacionit, si dhe 1/3 e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

KOMENTET NGA INSTITUTI DEMOKRATIK I KOSOVËS (KDI):

Neni 5 paragrafi 7 argumenton arsyet mbi bazën e të cilave mund të shkarkohet delegacioni si: mos puna, mospërgjigja ndaj komisionit ad hoc, kur nuk respektohet platforma dhe këtë mund ta bëjnë bashkëdrejtuesit dhe 1/3 e deputetëve.

Çfarë ndodh nëse një grup i deputetëve siç parashihet në pikën 7.5. evidenton shkeljen e procedurave, mospërmbushjen e detyrave, mospërgjigjet ndaj Komisionit ad hoc, evidenton shmangien nga platforma, por mungon gatishmëria e shumicës 50%+1 për të votuar shkarkimin e Delegacionit Shtetëror?

A nënkupton kjo që Delegacioni Shtetëror vazhdon punën e tij edhe në kundërshtim me vet ligjin në mungesë të numrave për të votuar për të kundërtën? A do duhej që shkelje të tilla ta shkarkojnë automatikisht delegacionin shtetëror?

Neni 6

Shoqëria Civile në Delegacionin Shtetëror

1. Përfaqësuesi i shoqërisë civile në Delegacionin Shtetëror propozohet dhe emërohet me konsensus nga Bashkëdrejtuesit e Delegacionit.

2. Në rast të mos-dakordimit konsensual mes bashkëdrejtuesve për emërimin e përfaqësuesit të Shoqërisë Civile, ai/ajo do të propozohet dhe do të emërohet me 2/3 e votave të Delegacionit Shtetëror. Shkarkimi i tij/saj bëhet me procedurë të njëjtë me atë që zbatohet gjatë zgjedhjes.

Neni 7

Themelimi i Komisioneve Punuese

1. Komisionet Punuese themelohen nga Delegacioni Shtetëror.

2. Komisionet janë përgjegjëse për zhvillim të negociatave për temat e veçanta, në bazë të Platformës Shtetërore dhe Strategjisë së miratuar nga Delegacioni shtetëror.

3. Komisionet Punuese përbëhen nga përfaqësues politikë të deleguar nga partitë politike parlamentare, si dhe nga ekspertë përcjellës të fushave përkatëse të komisioneve.

Neni 6

Shoqëria civile në delegacionin shtetëror

Në çfarë rasti shkarkohet personi i shoqërisë civile? Mbi çfarë shkeljes? Mbi çfarë kriteresh? Kujt i raportojnë bashkëkryesit ose anëtarët e tjerë të delegacionit për shkeljet e anëtarit të shoqërisë civile?

Pse nuk aplikohet e njëjta mënyrë e emërimit dhe shkarkimit të anëtarit të shoqërisë civile si për anëtarët e tjerë? Pse trajtohet veçmas anëtari i shoqërisë civile? Pse përdoren standarde të ndryshme për anëtarin e shoqërisë civile nga anëtarët e tjerë të delegacionit kur edhe ai/ajo ka të drejtë vote?

Pse nuk i përgjigjet anëtari i shoqërisë civile Kuvendit të Kosovës por vetëm bashkëkryesuesve të delegacionit shtetëror?

Neni 7

Themelimi i komisioneve punuese

Sipas këtij neni komisionet punuese themelohen nga delegacioni shtetëror dhe janë përgjegjës për zhvillim të negociatave sipas platformës dhe strategjisë.

Neni 7 paragrafi 3, mbi çfarë kriteresh bëhet përzgjedhja e ekspertëve të fushave?

A mund t'i ftoj komisioni Ad Hoc parlamentar, komisionet e tjera parlamentare apo Kuvendi në raportim komisionet punuese?

KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

4. Delegacioni Shtetëror vendos për numrin e Komisioneve Punuese duke u bazuar në Platformën Shtetërore, agjendën e Dialogut dhe Strategjinë Negociuese të Delegacionit.

5. Delegacioni Shtetëror gëzon të drejtën ekskluzive të shuarjes së ndonjë komisioni përkatës kur konsideron se një i tillë pushon së qeni i nevojshëm.

6. Themelimi apo shuarja e një komisioni bëhet me propozim të Bashkëdrejtuesve të Delegacionit Shtetëror dhe me vota të anëtarëve të Delegacionit.

7. Pavarësisht numrit të komisioneve punuese, pozitat drejtuese do të ndahen barabarësisht mes Koalicionit Qeverisës dhe Opozitës sipas proporcionit 50/50.

Neni 8

Komisioni Ad Hoc Parlamentar për Mbikëqyrjen e Dialogut

1. Komisioni Ad-hoc Parlamentar për Mbikëqyrjen e Dialogut do të themelohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në pajtim me Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Ai do të përbëhet nga përfaqësues të të gjitha subjekteve parlamentare dhe do të plotësohet me anëtarë vëzhgues të përzgjedhur nga shoqëria civile.

KOMENTET NGA INSTITUTI DEMOKRATIK I KOSOVËS (KDI):

Neni 7 paragrafi 7, nuk është e qartë nëse komisionet punuese do të drejtohen nga anëtarë të Delegacionit shtetëror apo nga anëtarë të tjerë të partive parlamentare.

Neni 8

Komisioni Ad Hoc Parlamentar për Mbikëqyrjen e Dialogut

Sipas Rregullore, Komision Ad Hoc Pa ka të drejtë të ftoj secilin zyrtar të Kosovës që e sheh të arsyeshme për të dëshmuar para komisionit. A mund t'i ftoj Komisioni Ad Hoc, Komisionet punuese në raportim?

Rregullorja e Kuvendit nuk parasheh anëtarë vëzhgues si anëtarë të Komisioneve Parlamentare.

Neni 65, pika 1 e rregullores së Kuvendit përcakton që mbledhjet e komisioneve janë të hapura përveç në rastet kur komisioni e vlerëson ndryshe (arsyet janë të përcaktuara në Rregullore)

A janë të hapura apo të mbyllura takimet e këtij Komision Ad Hoc Parlamentare? Pse është paraparë që të ketë përfaqësues vëzhgues të Komisionit? Kush i përzgjedh ata? Mbi çfarë kriteresh?

KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

2. Komisioni Ad-hoc Parlamentar për Mbikëqyrjen e Dialogut do të udhëhiqet nga një përfaqësues i partive opozitare, pjesëmarrëse në procesin e Dialogut.

3. Komisioni Ad-hoc Parlamentar për Mbikëqyrjen e Dialogut përbëhet nga njëmbëdhjetë anëtarë (11).

4. Pas themelimit të Komisionit, Kryesia e Kuvendit e shqyrton dhe e miraton buxhetin e propozuar nga komisioni.

KREU III

FUNKSIONIMI, KOMPETENCAT, VENDIMARRJA

Neni 9

Funksionimi i Delegacionit Shtetëror

1. Delegacioni Shtetëror i mandatuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës funksionon sipas dokumenteve themelore në vijim:

- 1.1. Platformës Shtetërore, dhe
- 1.2. Strategjisë Negociuese të Delegacionit Shtetëror.

KOMENTET NGA INSTITUTI DEMOKRATIK I KOSOVËS (KDI):

Neni 8 paragrafi 2. i jep të drejtën vetëm partive të opozitës të cilat janë pjesë e delegacionit të udhëheqin Komisionin Ad Hoc.

Ky nen do të duhej të ofronte mundësinë e udhëheqjes së Komisionit nga partia më e madhe opozitare në Kuvend. Pa e përcaktuar nëse është apo nuk është pjesë e delegacionit shtetëror.

Neni 8 paragrafi 3. Çfarë ndodhë nëse nuk marrin pjesë anëtarët nga partitë e tjera opozitare?

KREU III

FUNKSIONIMI, KOMPETENCAT, VENDIMARRJA

Neni 9

Funksionimi i Delegacionit Shtetëror

Neni 9 paragrafi 1: A nuk do duhej të përfshihej edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës, si pjesë e dokumenteve themelore mbi të cilat funksionon Delegacioni Shtetëror?

Kompetencat e Delegacionit Shtetëror

1. Bashkëdrejtuesit janë përfaqësues të Delegacionit Shtetëror.

2. Delegacioni Shtetëror nuk mund ta udhëheqë ose përfaqësojë vetëm njëri nga bashkëdrejtuesit.

3. Delegacioni Shtetëror është organi i vetëm që mban të drejtën për publikimin dhe procedimin e marrëveshjeve të arritura në procesin e dialogut.

4. Delegacioni Shtetëror:

4.1. Drejton procesin e dialogut me Serbinë;

4.2. Përfaqëson Republikën e Kosovës në Dialog;

4.3. Miraton Strategjinë e përgjithshme Negociuese si dhe strategjitë e veçanta për temat e Dialogut;

4.4. Bashkërendon agjendën e Dialogut me Platformën Shtetërore në dakordancë me lehtësuesit/ndërmjetësuesit e Dialogut;

4.5. Bashkërendon takimet me krerët e tjerë institucionalë (President, Kryeministër, Kryetar i Kuvendit, Ministra etj.) kurdo që e konsideron të nevojshme mbajtjen e tyre;

4.6. I raporton Komisionit Mbikëqyrës të Kuvendit pas çdo takimi me delegacionin e Republikës së Serbisë, dhe/ose me lehtësuesit/ndërmjetësuesit e Dialogut;

4.7. Miraton pozicionet fillestare negociuese të Republikës së Kosovës për secilën temë të Dialogut;

5. Delegacioni Shtetëror koordinon veprimet me institucionet e tjera kushtetuese që ndërliken me procesin e dialogut.

Kompetencat e Delegacionit Shtetëror

Neni 10 paragrafi 2: Çfarë ndodh kur njëri nga bashkëdrejtuesit mungon me arsye?

Neni 10 paragrafi 3. A është kjo kompetencë e delegacionit shtetëror në përputhje me kompetencat kushtetuese të institucioneve të Kosovës?

Neni 10 paragrafi 4. Me këtë nen duhet të rregullohet edhe raportimi i delegacionit shtetëror në seancat plenare të Kuvendit të Kosovës dhe komisionet e tjera - në bazë të fushëveprimit të tyre, përveç se në Komisionin Ad Hoc.

Kompetencat e Kuvendit të Republikës së Kosovës të parapara me Nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës nuk mund të kufizohen.

Gjithashtu në këtë nen duhet të shtohet që raportimi i Delegacionit Shtetëror duhet të bëhet pas çdo ftese të Kuvendit, Komisionit Ad Hoc Parlamentar dhe Komisioneve të tjera Parlamentare.

Neni 10 paragrafi 5 - Cilat janë veprimet për të cilat nevojitet koordinim? Çfarë ndodh në momentin kur nuk ka pajtueshmëri në mes të institucioneve kushtetuese dhe delegacionit shtetëror për një çështje të caktuar?

Neni 11

**Raporti i Delegacionit Shtetëror me
Institucionet Kushtetuese**

1. Institucionet Kushtetuese të Republikës së Kosovës do të angazhohen në Dialog sipas mandatit të tyre kushtetues dhe gjithnjë me bashkërendim dhe me dakordim në mes të institucioneve përkatëse të Republikës së Kosovës dhe Delegacionit Shtetëror.

2. Në rastet kur ndonjërit nga Institucionet Kushtetuese të Republikës së Kosovës (Presidenti, Kryeministri, Kryeparlamentari, etj.) i dërgohet ftesë formale nga ana e ndërmjetësuesit në procesin e Dialogut, vendimi për të do të merret gjithnjë në bashkërendim dhe dakordim në mes të Delegacionit Shtetëror dhe institucionit kushtetues të ftuar. Në çdo takim të tillë, përveç institucionit të ftuar të pranishëm do të jenë edhe bashkëdrejtuesit e Delegacionit Shtetëror.

3. Cfarëdo veprimi i institucioneve të Republikës së Kosovës në raport me Republikën e Serbisë duhet të bashkërendohen dhe të miratohen dyanshëm në mes institucioneve të Republikës së Kosovës dhe Delegacionit shtetëror.

4. Të gjitha Institucionet Kushtetuese të Republikës së Kosovës obligohen që t'i vënë në dispozicion të gjithë dokumentacionin e prodhuar gjatë procesit të deritashëm të Dialogut Teknik, si dhe t'i mundësojnë të gjitha resurset e nevojshme sipas kërkesave së Delegacionit Shtetëror.

Neni 11

**Raporti i Delegacionit Shtetëror me
Institucionet Kushtetuese**

Neni 11 paragrafi 2

Ky nen duhet të jetë në përputhje me nenin 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, pasi që çfarëdo devijimi nga Neni 4 i Kushtetutes mund të konsiderohet cënim i rendit kushtetues.

Me Nenin 4 të Kushtetutës së Kosovës, Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me [...] Kushtetutë.

A është Kryeparlamentari kategori kushtetuese? A nënkupton bashkërendimi me Kryeparlamentarin bashkërendimin me institucionin e Kuvendit të Republikës së Kosovës?

Neni 11 Paragraf 3 - Ky nen i këtij ligji është në kundërshtim me kompetencat kushtetuese të institucioneve siç është Kuvendi i Republikës së Kosovës, Presidenca, Qeveria.

Neni 12

Kompetencat administrative të bashkëdrejtuesve dhe Delegacionit Shtetëror

1. Bashkëdrejtuesit e Dialogut do ta themelojnë Zyrën e Koordinatorit Administrativ të Dialogut. Me propozim të bashkëdrejtuesve, Koordinatorit zgjidhet me votën e 2/3 të gjithë anëtarëve të Delegacionit Shtetëror.
2. Funksonimi i Zyrës së Koordinatorit Administrativ rregullohet me akt të veçantë nënligjor i cili miratohet nga Delegacioni Shtetëror.

Neni 13

Vendimmarrja në Delegacionin Shtetëror

1. Mbledhjet e Delegacionit Shtetëror mbahen nëse të pranishëm janë 50% +1 të anëtarëve të tij.
2. Vendimet në Delegacionin Shtetëror merren me unanimitet, pajtueshmëri të të gjithë anëtarëve të tij.
3. Nëse pas dy tentimeve për vendimmarrje dëshmo-het se unanimiteti është i pamundshëm, një vendim konsiderohet i miratuar kur i fiton votat e dy të tretave (2/3) të të gjithë anëtarëve të pranishëm.
4. Nëse para, dhe gjatë një mbledhjeje, të Delegacionit Shtetëror konstatohet mungesa e kuorumit, Bashkëdrejtuesit e ndërprejnë mbledhjen për një kohë të caktuar. Nëse brenda kësaj kohe nuk arrihet kuorumi, Bashkëdrejtuesit përfundojnë mbledhjen dhe thërrasin mbledhje tjetër brenda një afati jo më të gjatë se dy (2) ditë.

Neni 12

Kompetencat administrative të bashkëdrejtuesve dhe Delegacionit Shtetëror

Neni 13

Vendimmarrja në Delegacionin Shtetëror

Neni 13 paragrafi 3 – Vendimmarrja nga Delegacioni shtetëror, në secilin rast, duhet të merret me shumicë të kualifikuar (2/3) të të gjithë anëtarëve të delegacionit shtetëror.

Neni 14

Mbledhjet e Delegacionit Shtetëror

1. Mbledhja e parë konstituive e Delegacionit Shtetëror thirret nga Bashkëdrejtuesit jo më vonë se shtatë (7) ditë nga data e marrjes së vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për themelimin e Delegacionit Shtetëror.

2. Me kërkesë të shumicës së nevojshme (50%+1) të anëtarëve të Delegacionit Shtetëror, njëri nga Bashkëdrejtuesit obligohet të thërret mbledhje të Delegacionit Shtetëror për datën e kërkuar nga anëtarët propozues.

Neni 15

Diskrecioni publik dhe ruajtja e të dhënave

1. Mbledhjet e Delegacionit Shtetëror janë të mbyllura, përveç në raste kur Delegacioni vendos për seancë të hapur.

2. Delegacioni Shtetëror mund të vendosë për mbledhje të hapur me shumicë të thjeshtë të votave të anëtarëve të tij.

3. Kërkesën për mbledhje të hapur mund ta bëjë një (1) anëtar i pranishëm i Delegacionit.

4. Vendimi për mbledhje të hapur bëhet i ditur nga njëri ose dy Bashkëdrejtuesit e Delegacionit.

5. Mbledhjet e Delegacionit Shtetëror incizohen vetëm përmes mjeteve elektronike zyrtare të Kuvendit dhe ruhen si sekret zyrtar, përveç nëse Delegacioni vendosë ndryshe.

Neni 14

Mbledhjet e Delegacionit Shtetëror

Si duhet të cilësohen veprimet e ndërmarra nga Delegacioni Shtetëror para hyrjes në fuqi të këtij ligji? Sipas këtij neni i tërë Delegacioni shtetëror duhet të votohet nga Kuvendi pas hyrjes në fuqi të këtij ligji në mënyrë që të ketë kompetencë për të vepruar.

Neni 15

Diskrecioni publik dhe ruajtja e të dhënave

Neni 15 paragrafi 1. Fjala seancë, duhet të zëvendësohet me fjalën mbledhje.

6. Anëtarët e Delegacionit Shtetëror dhe stafi mbështetës obligohet ta ruajë sekretin e informacionit dhe të ecurisë së punës së Delegacionit.

7. Shkelja e këtij neni, do të sanksionohet sipas Ligjit përkatës.

KREU IV

DISPOZITAT E TJERA

Neni 16

1. Administrata e Delegacionit Shtetëror ofron mbështetje administrative dhe teknike për nevojat të Delegacionit, të Komisioneve Punuese dhe të anëtarëve individualë të Delegacionit Shtetëror.

2. Koordinatorit Administrativ i Delegacionit Shtetëror është udhëheqës i administratës së Delegacionit në vartësi të bashkëdrejtuesve dhe të Delegacionit Shtetëror.

3. Organizimi i punës së shërbimeve të administratës së Delegacionit Shtetëror, si dhe të drejtat dhe obligimet e tjera, rregullohen me akt të veçantë nënligjor të cilin e miraton Delegacioni me propozim të Koordinatorit Administrativ.

Neni 17

Buxheti i Delegacionit Shtetëror

1. Për veprimtarinë e tij, Delegacioni Shtetëror e ka fondin e veçantë të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me propozim të Delegacionit.

2. Delegacioni Shtetëror menaxhon në mënyrë autonome me buxhetin e caktuar nga Qeveria dhe paraqet raport sipas nevojave të Qeverisë dhe Kuvendit.

Neni 18

Dispozitat përfundimtare

Delegacioni Shtetëror mund të nxjerr rregulla të brendshme sipas nevojës, të cilat nuk mund të jenë në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 19

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.

Për më shumë informata rreth KDI ju lutem vizitoni www.kdi-kosova.org

Me përkrahjen financiare të:



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Federal Department of Foreign Affairs FDFA